

NËNCIMINI I MANDJEMADHËSISË

Shejhu: Abdul-Muhsin El-Kasim

1/7/1424H

Me të vërtetë falenderimet i takojnë Allahut. Atë e falenderojmë dhe vetëm prej Tij ndihmë dhe falje kërkojmë. Kërkojmë prej Allahut që të na ruajë nga të këqijat e veteve tona dhe nga punët tona të këqija. Atë që e udhëzon Allahu nuk ka se kush e humb dhe atë që Allahu e humb nuk ka se kush ta udhëzojë. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjeter përveç Allahut, Një dhe i pashtoq, dhe dëshmoj se Muhammedi është rob dhe i dërguari i Tij, falja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, mbi familjen dhe shokët e tij.

O ju muslimanë! Dijeni se rregullimi i birit të Ademit arrihet me besim dhe punë të mira. Puna për rregullimin e zemrës është më e mirë sesa adhurimet nafile. Punët e zemrës kanë shpërblimin dhe ndëshkimin njësoj si edhe punët e gjymtyrëve. Shpërblehesh për dashurinë dhe urrejtjen për hir të Allahut, shpërblehesh për mbështetjen tek Allahu si dhe nëse dëshiron që të bësh diçka të mirë. Njëkohësisht ndëshkohesh për mendjemadhësinë, smirën dhe syefaqësinë. Sa më i thjeshtë të jetë dhe sa më shumë adhurim të bëjë robi aq më shumë afrohet ai tek Zoti i tij dhe aq më shumë autoritet do të ketë. Origjina e gjithë veseve të këqija është mendjemadhësia, Iblisi e kishte këtë cilësi e ajo e bëri atë që ta kishte smirë Ademin alejhis-selam prandaj ai u tregua mendjemadh dhe nuk pranoi që t'i bindej urdhërit të Zotit të tij "E kur u thamë engjëjve: Bini në sexhde për Ademin, ata menjëherë iu përulën, me përjashtim të Iblisit (djallit). Ai rrefuzoi dhe u tregua mendjemadh dhe u bë prej jobesimtarëve." (El-Bekare: 34) Për shkak të mendjemadhësise jehudët u larguan nga besimi edhe pse e panë Muhammedin alejhis-selam dhe e ditën se profecia e tij ishte e vërtetë. Mendjemadhësia e ndaloj të birin e Ubej ibn Selulit që të nënshtrohej para së vërtetës. Ajo e ndaloj Ebu Xhehlin nga pranimi i Islamit. Për shkak të saj kurejshët zgjodhën humbjen dhe lanë udhëzimin. Allahu i Madhëruar ka thënë: (Ky është komentimi i ajetit) "**Ata, kur u thuhej: Nuk ka të adhuruar tjeter përveç All-llahut. tregoheshin mendjemëdhenj.**" (Es-Saffat: 35) Sulejmani alejhis-selam e thirri Belkisen dhe popullin e saj që mos të përpinqeshin të lartësoheshin mbi të tjerët por të bindeshin. "**Të mos mbaheni me të madhe kundër meje, po të vini të dorëzuar (besimtarë)!**" (En-Neml: 31) Ajo është shkak për përcarje, mosmarrveshje dhe urrejtje. Allahu i Madhëruar ka thënë për Beni Israilët: (Ky është komentimi i ajetit) "**Mirëpo, për shkak të zilisë që kishin ndërmjet vete, ata u përçanë vetëm atëherë kur u erdhi dija që ta kuptojnë ...**" (El-Xhathije: 17) Për shkak të saj Beni Israilët i përgënjeshtruan dhe i vranë pejgamberët e tyre. "**E sa herë që ju erdhi ndonjë i dërguar me çka nuk u pëlqeu juve, u bëtë mendjemëdhenj, disa prej tyre i përgënjeshtruat e disa i vratë?**" (El-Bekare: 87) Ajo është një nga cilësitë e

munafikëve "E kur u thuhet: Ejani te i dërguari i All-lahut që ai të kërkojë (prej Allahut) falje për ju. Ata tundin kokat e tyre dhe i sheh se si ta kthejnë shpinën duke u treguar mendjemëdhenj." (El-Munafikun: 5) Shumë prej popujve të mëparshëm u ndëshkuan sepse mendjemadhësia ishte një nga cilësitë e tyre, Allahu i Madhëruar për popullin e Nuhit alejhis-selam ka thënë: (Ky është komentimi i ajetit) "... dhe mbulonin kokat me teshat e tyre dhe vazhdonin në atë të tyren me një mendjemadhësi të fortë." (Nuh: 7) Dhe për faraonin ka thënë: (Ky është komentimi i ajetit) "Dhe ashtu ai dhe ushtria e tij u sollën në tokë me mendjemadhësi ndaj së vërtetës dhe menduan se nuk do të kthehen te Ne. Prandaj, Ne e kapëm atë dhe ushtrinë e tij dhe e hodhëm në det, shiko pra se si përfundojnë mizorët." (El-Kasar: 39-40) Për popullin e Hudit alejhis-selam ka thënë: (Ky është komentimi i ajetit) "Sa i përket Adit, ata pa pasur kurrfarë të drejte, u treguan mendjemëdhenj ndaj banorëve në tokë dhe thanë: Kush ka fuqi më të madhe se ne? A nuk e ditën ata se All-lahu, i cili i krijoj ka fuqi më të madhe se ata?! Ata i mohuan argumentet tona. Prandaj Ne kundër tyre lëshuan një erë shumë të ftohtë gjatë disa ditëve fatzeza për t'u dhënë të përjetojnë dënimin nënçmues në jetën e kësaj bote, ndërsa dënim i në botën tjetër do të jetë edhe më nënçmues dhe ata nuk do të ndihmohen." (Fussilet: 15-16)

Mendjemëdhenjtë kanë qenë gjithmonë armiq të pejgamberëve dhe pasuesve të tyre "Paria, që ishte kryelartë nga populli i tij, tha: O Shuajb, ne do të dëbojmë ty dhe së bashku me ty edhe ata që besuan nga fshati ynë, ose patjetër do të ktheheni në fenë tonë." (El-A`raf: 88) Musai alejhis-selam kërkoi imbrojtjen e Allahut prej tyre "Musai tha: Unë u imbrojta me Zotin tim dhe Zotin tuaj prej çdo mendjemadhi, që nuk i beson ditës së llogarisë!" (Gafir: 27)

Mendjemadhi pason epshet e tij, e shikon veten e tij si të përsosur ndërsa të tjerët i shikon si mangët. Zemra e tij është e vulosur dhe nuk pranon asgjë tjetër përvëç asaj që ia dëshiron epshi i tij. "Në këtë mënyrë All-lahu vulos zemrat e atyre që nuk kuptojnë." (Err-Rrum: 59) Allahu i Madhëruar e urren mendjemadhësinë "... me të vërtetë All-lahu nuk e do asnjë mendjemadhi që mburret." (Lukman: 18) Mendjemadhi nuk mund të pranojë këshillën e as të nxjerrë mësimë "Unë do t'i largoj nga argumentet e Mia ata të cilët pa pasur të drejtë tregohen mendjemëdhenj në tokë ..." (El-A`raf: 46)

Ai që tregohet mendjemadhi ndaj së vërtetës sprovohet duke iu nënshtruar së kotës dhe ndodh që të ndëshkohet për të që në dynja. Një personit në kohën e Muhammedit alejhis-selam iu paralizua dora për shkak të mendjemadhësisë. Seleme ibnul-Eküe ka thënë: Një burrë hëngri me dorën e majtë para Muhammedit alejhis-selam. Ai i tha: "Ha me të djathtën!" Tha: Nuk mundem. Tha: "Kurrë mos mundsh." Nuk e ndaloi nga ajo gjë veçse mendjemadhësia e pas asaj dite nuk e ngriti më dorën e tij në gojë. Transmetoi Muslimi. Kushdo i cili ka sado pak mendjemadhësi në zemrën e tij, nuk do të hyjë në Xhennet. Muhammedi alejhis-selam ka thënë: "Ndërsa një burrë po ecte i veshur me një rrobë të bukur duke i pëlqyer vetja e tij, me flokë të lyer, Allahu e bëri që të fundosej në tokë e kështu do të ndëshkohet deri në ditën e Kijamitetit." Transmetoi Buhariu dhe Muslimi. Në botën tjetër ai ndëshkohet me të kundërtën e asaj që dëshironte, kush përpinqet që të tregohet më i lartë se të tjerët, në ditën e Kijamitetit kanë për ta shtypur njerëzit me

këmbë. Muhammedi alejhis-selam ka thënë: "*Kryeneçët dhe mendjemëdhenjtë do të ringjallen ditën e Kijametit në madhësinë e një grimce e njerëzit do t'i shkelin me këmbët e tyre.*" Transmetoi Tirmidhiu. "*Nuk do të futet në Xhennet ai në zemrën e të cilit ka sa një grimcë mendjemadhësi.*" Transmetoi Buhariu.

Zjarri është banesa e tyre "A nuk është në Xhehenem vendi i mendjemëdhenje?" (Ez-Zumer: 60) Muhammedi alejhis-selam ka thënë: "*Foli Xhenneti dhe Zjarri. Tha Zjarri: Tek unë ka vetëm kryelartë dhe mendjemëdhenj. E tha Xhenneti: Tek unë janë vetëm të dobëtit dhe më të varfërit e njerëzve.*" Transmetoi Muslimi.

O ju muslimanë! Mendjemadhësia është një nga të veçantat e Zotit të Madhëruar dhe e askujt tjetër. Nëse ndonjë prej krijesave e zgjedh këtë si cilësi të tij, atë ka për ta ndëshkuar Allahu. Muhammedi alejhis-selam transmeton prej Zotit të tij në një hadith kudsi se Ai ka thënë: "*Krenaria është izari* (veshja e poshtme) *Im ndërsa mendjemadhësia është ridai* (veshja e lartme) *Im. Kush më kundërshton në njérën prej tyre kam për ta ndëshkuar.*" Transmetoi Muslimi.

Islami ka ndaluar nga çdo rrugë që të çon drejt mendjemadhësisë prandaj ndaloj veshjen e mëndafshit dhe floririt për burrat sepse ato mund ta çojnë atë në mendjemadhësi. Atij që zgjat robën e tij poshtë syrit të këmbës i është premtuar ndëshkim. Muhammedi alejhis-selam ka thënë: "*Tre personave nuk u flet Allahu ditën e Kijametit, nuk shikon tek ta, nuk i pastron* (nga gjynahet) *dhe për ta do të ketë ndëshkim të dhimbshëm.*" E tha këtë tre herë. Ebu Dherr tha: Me të vërtetë që kanë humbur e janë shkatërruar, kush janë ata o i Dërguar i Allahut? Tha: "*Ai që zgjat rrobën poshtë syrit të këmbës, ai që përmend të mirën që bën dhe ai që shet mallin e tij duke u betuar në gënjeshtër.*" Transmetoi Muslimi.

Gjithashtu është e ndaluar tu kthesha shpinët njerëzve nga mendjemadhësia (e mos t'i shikosh drejt në sy) si dhe të ecet me mendjemadhësi përvëçse në luftë (para armikut). Allahu i Madhëruar ka thënë: (Ky është komentimi i ajetit) "**Dhe mos shtrembëro fytyrën tënde prej njerëzve e mos ec nëpër tokë kryelartë ...**" (Lukman: 18) Prandaj hiqë rrobën e mendjemadhësisë sepse ajo nuk është për ty por është për Zotin tënd dhe vishe rrobën e thjeshtësisë sepse nuk hyn diçka prej mendjemadhësisë në zemrën e dikujt veçse i pakësohet atij llogjika. E gjithë kjo vjen si pasojë e mosnjohjes që robi ka për Zotin dhe veten e tij e nëse do ta kishte njohur Zotin dhe cilësitë e Tij e do të kishte njohur veten e tij të mangët, nuk do të kishte ndodhur kjo. Sufjan ibn Ujejne ka thënë: *Frikësahu për atë që kundërshton nga mendjemadhësia sepse Iblisi kundërshtoi nga mendjemadhësia dhe për këtë u mallkuva.*

Kush i hap vetes derën e mendjemadhësisë veçse i ka hapur asaj dyert e së keqes e kush ia mbyll vetes atë derë veçse i ka hapur vetes dyert e mirësisë së gjerë e kjo me dëshirën e Allahut. Mendjemadhësia që çon në kundërshtimin e besimit e bën personin që të mos futet në Xhennet siç thuhet në ajetin (ky është komentimi i tij) "... e ata që nga mendjemadhësia i shmangen adhurimit ndaj Meje, do të hyjnë të nënçmuar në Xhehenem." (El-Gafir: 60)

Ka prej mendjemadhësisë që të çon në kundërshtimin e besimin të detyruar e ajo e bën personin që të mohojë të vërtetën dhe të përçmojë krijesat. Muhammedi alejhis-selam ka thënë: "*Nuk do të futet në Xhennet ai në zemrën e të cilit ka sa një grimcë mendjemadhësi.*" Thanë: O i Dërguar i Allahut! Personi dëshiron që rroba e

tij tē jetë e bukur dhe shapkat e tij tē jenë tē bukura. Tha: "*Mendjemadhësia është tē mohosh tē vërtetën dhe tē përcëmosh njerëzit.*" Transmetoi Muslimi.

O ju muslimanë! Dijeni se thjeshtësia e bën njeriun tē jetë i lartësuar dhe i nderuar në dynja dhe Ahiret siç ka thënë Muhammedi alejhis-selam: "*Nuk thjeshtësohen dikush pér hir tē Allahut veçse e lartëson atë Allahu.*" Transmetoi Muslimi. Thjeshtësia është një nga cilësitë e pejgamberëve dhe njerëzve tē shqar. Musai alejhis-selam ndihmoi dy gra, babai i tē cilave ishte plak i moshuar, Daudi alejhis-selam hante nga ajo që fitonte me duart e tij, Zekerija ishte marangoz ndërsa Isai alejhis-selam thoshte: "**Më ka bërë tē mirësellshëm ndaj nënës sime, e nuk më ka bërë kryelartë e as tē padëgjueshëm!**" (Merjem: 32)

Nuk ka asnjë profet veçse gjatë jetës së tij kishte qenë çoban me bagëti. Muhammedi alejhis-selam ka qenë zemërbutë, i mëshirshëm, i butë me besimtarët, ndihmonte tē tjerët, qepej mbi gomar, përshëndeste tē vegjëlit dhe gjithmonë përshëndeste i pari, i përgjigjej ftesës së gjithkujt. Kur Aishja (Allahu qoftë i kënaqur prej saj!) u pyet pér tē se çfarë bënte në shtëpi tha: *Ishte gjithmonë në shërbim tē familjes së tij e kur vinte koha e namazit shkonte pér tu falur.* Transmetoi Buhariu.

Thjeshtësia është shkak që në shoqëri tē mbahet drejtësi e tē ketë dashuri e afritimet mes njerëzve. Muhammedi alejhis-selam ka thënë: "*Allahu më shpalli urdhërin që tē jemi tē thjeshtë që kështu askush mos tē mburret para tē tjerëve dhe askush mos t'i bëjë padrejtësi tē tjerëve.*" Transmetoi Muslimi.

Atw person që është i thjeshtë e gjen gjithnjë tē përulur para Allahut, i mëshirshëm me robërit e Tij, nuk e gjen që tē këtë marrë hakun e dikujt përkundrazi gjithmonë u bën mirë tē tjerëve e kjo është një cilësi tē cilën Allahu i Madhëruar ia jep kujt tē dojë prej robërve tē Tij.

O ju muslimanë! Pas thjeshtësisë që duhet treguar para Allahut thjeshtësia më e pëlqyer është ajo para prindërve duke u treguar bamirës me ta, duke i nderuar ata, duke iu bindur atyre nëse nuk ka në këtë gjë kundërshtim tē Allahut, duke iu buzëqeshur, duke folur me ta me butësi, duke i respektuar, duke u lutur pér ta kur ata janë gjallë dhe pas vdekjes së tyre. Allahu i Madhëruar ka thënë: (Ky është komentimi i ajitet) "**Dhe në shenjë mëshire shtrije pranë tyre krahun përulës e respektues dhe thuaj: Zoti im! Mëshiroji ata tē dy, sikurse më edukuan mua kur isha i vogël.**" (El-Isra: 24)

Tregohu i thjeshtë në fe dhe mos e kundërshto atë me mendimet apo epshet e tua. Mos nguro pér ta mësuar dhe pér tē punuar me tē. Nëse dikush tē këshillon pranoje atë këshillë prej tij dhe falenderoje atë. Nëse dikush tē urdhëron pér një tē mirë ose tē ndalon nga diçka e keqe bindju atij. Fudejl ibn Ijadhi (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: *Thjeshtësia është t'i nënshtrohesh tē vërtetës dhe t'i bindesh asaj. Dikush i tha Malik ibn Miguelit: Frikësoju Allahut. E ai e uli faqen e tij në tokë.*

Mësuesi dhe nxënësi duhet që tē tregohen tē thjeshtë ndaj njëri-tjetrit. Shejhu i muhadithinëve Ebu Musa El-Medijni u mësonte fëmijëve lexiimin e Kur'anit dhe ulej me ta, me gjithë autoritetin e lartë që kishte.

Tregohu i thjeshtë me tē sëmurët duke i vizituar ata, duke qëndruar përkrah tyre, duke u lehtësuar atyre vuajtjet me sa tē kesh mundësi dhe duke u përkujtuar atyre se duhet tē jenë tē kënaqur dhe tē shpresojnë shpërbllimin. Tregohu i afërt me tē varfërit dhe tē vobektit, shikojti fytyrat e atyre që kanë turp tē lypin dhe ndihmoji ata. Bishr

ibn Harith (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: *Nuk kam parë gjë më të bukur sesa një i pasur që ulet para të varfërit.*

"**Atë vend të përjetshëm** (Xhennetin) ua kemi përcaktuar atyre që nuk duan as mendjemadhësi e as ngatërrresë në tokë, e përfundimi i këndshëm u takon atyre që janë të **devotshëm**." (El-Kasas: 83)

O ju muslimanë! Nderi arrihet duke iu nënshtuar Allahut dhe duke u treguar i thjeshtë me muslimanët e duke qenë i duruar me ta. "... **dhe shtriji krahët e tu** (të mëshirës) **për besimtarët**." (El-Hixhr: 88)

Përveç kësaj mos harro leximin e Kur'anit, të haditheve profetike, sillu mirë, bë të mira, mos dëmto askënd, mos përgojo dhe mos fut të tjerët në sherr, mundohu që më shumë tu bësh mirë njerëzve sesa të përsitosh prej tyre. I thjeshtë është ai i cili kur shikon dikë tjetër thotë: Ky është më i mirë se unë. Shafiu (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: *Njeriu me autoritet më të lartë është ai i cili nuk i jep rëndësi autoritetit të tij, njeriu me mirësi më të mëdha është ai i cili nuk përpigjet të shikojë mirësitë që ka. Nëse Allahu të begaton me diçka prite atë me falenderim.*

O robërit e Allahut! Allahu ju ka urdhëruar me diçka për të cilën filloi vetë i pari duke thënë: (Ky është komentimi i ajetit) "**Me të vërtetë Allahu dhe engjëjt e Tij e lavdërojnë Pejgamberin.** O ju që keni besuar, lavdërojeni atë (duke bërë salavate për të) **dhe përvendeteni me selam**." (El-Ahzab: 56)

www.alharamainonline.org

SHKAQET QË TË BËJNË TA DUASH ALLAHUN

Shejhu: Husejn Ali Shejh

8/7/1424H

Transmeton Buhariu dhe Muslimi nga Enes ibn Malik (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se një burrë shkoi tek i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ue sel-lem dhe i tha: *O i Dërguari i Allahut, kur do të ndodhë Kijameti?* Tha: "*Cfarë ke prebatitur për të?*" Tha: *Nuk kam prebatitur shumë namaz, agjërim dhe sadaka por unë e dua Allahu dhe të Dërguarin e Tij.* Tha: "*Ti do të jesh me ata që do.*" Enesi thotë: Pas gëzimit për hyrjen në Islam nuk jemi gjëzuar për diçka tjetër më shumë sesa për thënien e të Dërguarit të Allahut: "*Ti do të jesh me atë që do.*"

Në sahinhun e Muslimit transmetohet se Enesi ka thënë: *Ndërsa unë e dua Allahu, të Dërguarin e Tij, Ebu Bekrin dhe Umerin e shpresoj që të jem me ta edhe nëse nuk veproj si ata.* Ibn Kajjimi (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: *Ajo (dashuria për Allahu) është një pozitë për të cilën kanë konkuruar me njëri-tjetrin dhe kanë punuar ata që e duan të mirën, prej saj janë fryshtuar adhuruesit, ajo është ushqimi i zemrave dhe i shpirtrave, qetësia e syve, ajo ështëjeta e cila nëse i privohet dikujt ai bëhet prej të vdekurve, ajo është drita pa të cilën personi ngelet në detin e errësirave, kush privohet prej kësaj kënaqësie ka për ta kaluar jetën e tij në vuajtje dhe dhimbje. Pasha Allahu, ata që e kanë gjetur atë kanë fituar një nder të madh në këtë dynja dhe në Ahiret sepse kanë gjetur një fat të rrallë.*

O vëllezër të fesë! Dijetarët kanë përmendur shkaqe, rrugë dhe parime që të ndihmojnë në arritjen e kësaj pozite.

E para: Leximi i Kur'anit dhe kuptimi i përbajtjes, të fshehtave dhe mençurisë që gjendet në të. Një prej sahabëve deshi që të arrinte dashurinë e Allahut duke lexuar suren Ihlas, e lexonte atë shumë në namaz e kur u pyet pse e bënte një gjë të tillë tha: *Ajo tregon për cilësitë e Mëshiruesit dhe unë e pëlqej leximin e saj.* Muhammedi alejhis-selam tha: "*Lajmërojeni se Allahu e do atë.*" Transmetoi Buhariu.

E dyta: Afrimi tek Allahu duke vepruar adhurimet nafilë pas kryerjes së detyrave dhe duke iu përbajtur kufijve të caktuar. Muhammedi alejhis-selam në hadithin kudsi transmeton se Zoti i tij ka thënë: "... I kam shpallur luftë atij që dëmton një person që Unë e dua. Robi nuk mund të më afrohet më shumë sesa duke kryer atë që ia kam bërë detyrë. Robi vazhdon të veprojë nafilët derisa Unë ta dua atë. E nëse e dua atë atëherë kam për të qenë dëgjimi me të cilin ai dëgjon, shikimi me të cilin ai shikon, dora me të cilën vepron dhe këmba me të cilën ecën (kuptimi i kësaj është se ai në gjithçka do të jetë nën kujdesin e Allahut), e nëse më kërkon do t'i jap e nëse kërkon mbrojtje do ta mbroj."

E treta: Vazhdimësia në përmendjen e Allahut me fjalë, zemër dhe vepra në çdo gjendje qofsh. Allahu i Madhëruar ka thënë: (Ky është kometimi i ajetit) "*Pra më kujtoni Mua, Unë ju kujtoj juve.*" (El-Bekare: 152) Muhammedi alejhis-selam ka

thënë: "*Allahu i Madhëruar thotë: Unë jam me robin Tim për sa kohë që më përmend dhe për këtë lëvizin buzët e tij.*" Transmetoi Ibn Maxheh me sened të saktë. Dhe ka thënë: "*Kanë fituar muferridunët.*" Thanë: Kush janë muferridunët, o i Dërguar i Allahut? Tha: "*Ata dhe ato që e përmenden shumë Allahun.*" Transmetoi Muslimi.

E katërta: Dhënia përparësi e asaj që pëlqen Allahu dhe i Dërguari i Tij sado e vështirë që të jetë kjo. Prandaj robi i jep përparësi kënaqësisë së Allahut ndaj kënaqësisë së të tjerëve edhe nëse sprovat dhe harxhimet janë të shumta, edhe nëse kjo e dobëson trupin. Ibn Kajjimi (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: *Dhënia përparësi kënaqësisë së Allahut ndaj kënaqësisë së të tjerëve është të dëshirosh dhe veprosh çdo gjë që e kënaq Atë edhe nëse mërziten kriesat, kjo është pozita më e lartë të cilën e kanë arritur profetët, më të zgjedhurit prej tyre e në veçanti Muhammedi sal-lallahu alejhi ue sel-lem e kjo nuk mund të plotësohet veçse duke zbatuar tri çështje:*

1. *Ta nënshtosh epshin e vvetves.*
2. *Ta kundërshtosh epshin e vvetves.*
3. *Të luftosh shejtanim dhe pasuesit e tij.*

E pesta: Ushqimi i zemrës me kuptimin dhe njohjen e emrave dhe cilësive të Allahut dhe shëtitja në kopshtin e kësaj njohjeje. Kush njeh Allahun me emrat, cilësitet dhe veprimet e Tij të cilat janë vërtetuar me dy shpalljet (Kur'anin dhe Sunnetin) duke mos i ndryshuar, mohuar, krahasuar, treguar mënyrën se si janë apo komentuar me kuptim jo të saktë, atë person Allahu e do, e nderon dhe e kënaq. Allahu i Madhëruar ka thënë: (ky është komentimi i ajetit) "**All-llahu ka emrat më të mirë, prandaj Atë luteni me to ...**" (El-A`raf: 180) Muhammedi alejhis-selam ka thënë: "*Me të vërtetë Allahu ka nëntëdhjet e nëntë emra, kush i përbledh* (i numëron, kuption dhe punon me) ***ato do të hyjë në Xhennet.***"

E gjashta: Vështrimi dhe njohja e bamirësisë, të mirave dhe begative që Allahu i jep robit të Tij qofshin ato të dukshme apo të fshehta. Ato të bëjnë që ta duash Atë. Bamirësia dhe butësia ndjellin ndjenjat e njeriut dhe i sundojnë ato duke bërë që ta duash atë që të jep. Në të vërtetë nuk ka bamirës tjetër përvëç Allahut e për këtë argumenton mendja e qartë, ajetet Kur'anore dhe hadithet e sakta. Prandaj në të vërtetë nuk ka më të dashur që ta meritojë dashurinë tek ata që llogjikojnë dhe janë largpamës, përvëç Allahut të Madhëruar.

Natyrshtëria e njeriut është e tillë që e do atë që tregohet bamirës, i butë, i kujdeshëm dhe e ndihmon atë në arritjen e qëllimeve të tij. Nëse e kuption siç duhet këtë gjë atëherë mëson se ai i cili të jep mirësi është vetëm Allahu i Lartësuar dhe llojet e mirësisë së Tij janë të panumërtë ashtu siç ka thënë vetë Allahu i Madhëruar (ky është komentimi i ajetit): "... **dhe në qoftë se përpinqeni t'i numëroni mirësitë e Allahu, nuk do të mundeni t'i numëroni** (të gjitha). **Me të vërtetë njeriu është i padrejtë dhe shumë mohues** (i begative të Tij)." (Ibrahim: 34) atëherë mundet robi që të falenderojë Allahun me gjuhë, zemër dhe vepra e kështu fiton çdo mirësi e përfundim të mirë. Allahu i Madhëruar ka thënë: (Ky është komentimi i ajetit) "... **Nëse falënderoni, do tu shtoj** (të mirat) ..." (Ibrahim: 7) Muhammedi alejhis-selam ka thënë: "*Çudi me çështjen e besimtarit, ajo është e gjitha e mirë e një gjë e tillë nuk ndodh vetëm se me besimtarin. Nëse e godet diçka e keqe duron dhe kjo është e mirë për të.*" Transmetoi Muslimi. Gjithashtu ka thënë: "*Me të vërtetë Allahu*

kënaqet me robin i cili kur ha diçka e falenderon Allahun për të dhe kur pin diçka e falenderon Allahun për të." Transmetoi Muslimi.

E shtata: E kjo është më e rëndësishmjë e të gjithave, të thyesh zemrën tënde para Allahu të Madhëruar, të nënshتروھەش para Tij, të tregosh frikërespekt me fjalë dhe vepra, me zemër dhe trup para madhështisë së Tij. Allahu i madhëruar ka thënë: (Ky është komentimi i ajetit) "**Me të vërtetë kanë fituar besimtarët. Ata të cilët tregojnë frikërespekt gjatë faljes së namazit.**" (El-Mu`minun: 1-2) dhe për më të mirët prej robërvë të Tij ka thënë: (Ky është komentimi i ajetit) "**Ata shpejtonin për punë të mira dhe na luteshin duke shpresuar dhe duke u frikësuar ...**" (El-Enbija: 90)

E teta: Të arrish kohën e zbritjes hyjnore të Allahut të Madhëruar e ta lutësh Atë, të lexosh fjalën e Tij, ta adhurosh Atë e gjithë këtë ta vulosësh me kërkimin e faljes dhe pendimin tek Ai. Allahu i Madhëruar ka thënë për krijesat më të zgjedhura: (ky është komentimi i ajetit) "**I heqin trupat e tyre prej dyshekëve, duke e lutur Zotin e tyre me frikë dhe shpresë e nga ajo që Ne u kemi dhënë (pasuria) atyre, ata shpenzojnë** (për hir të Allahut)." (Es-Sexhde: 16) Ata që falen natën janë më të nderuarit e atyre që e duan Allahun sepse qëndrimi natën përpara Allahut i krijon atyre mundësinë për të vepruar shumicën e shkaqeve që të bëjnë ta duash Allahun. Prandaj mos të duket e çuditshme që besniku i qiellit Xhibrili alejhis-selam të zgresë tek besniku i tokës Muhammedi sal-lallahu alejhi ue sel-lem dhe t'i i thotë: "**Dije se nderi i besimtarit qëndron tek falja e natës ndërsa krenarina e tij qëndron tek moskërkimi i asgjëje prej njerëzve.**" Hadithi është i saktë.

Hasen El-Basri (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: *Nuk kam gjetur ndonjë adhurim më të vështirë sesa falja natën.* I thanë: Pse ata që falen natën kanë fytyrat më të mira? Tha: *Sepse kanë qëndruar vetëm për vetëm me Mëshiruesin e Ai u veshi drithë prej drithës së Tij.*

E nënta: Të duash njerëzit e mirë, të afrohesh dhe të ulesh me ta. Muhammedi alejhis-selam ka thënë: "**Allahu i Madhëruar ka thënë: Është bërë detyrë dashuria Ime për ata që duhen për hirin Tim. Është bërë detyrë dashuria Ime për ata që ulen për hirin Tim. Është bërë detyrë dashuria Ime për ata që vizitojnë njëritjetrin për hirin Tim.**" Albani ka thënë që hadithi është i saktë. Gjithashtu Muhammedi sal-lallahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "**Lidhja më e fortë e besimit është dashuria për hir të Allahut dheurrejtja për hir të Allahut.**" Hadithi është i saktë.

E dhjeta: Largimi nga çdo gjë që e largon zemrën nga Allahu i Madhëruar. Kjo arrihet duke u larguar nga të gjitha të këqijat, haramat dhe gjërat që të shkatërrojnë. Nëse zemra prishet atëherë njeriu në gjithçka që kryen nuk gjen dobi as për dynjanë e as për Ahiretin e Tij. Allahu i Madhëruar ka thënë: (Ky është komentimi i ajetit) "**Ditën kur nuk bën dobi as pasuria e as fëmijët. Përveç atij që i paraqitet Allahut me zemër të pastër.**" (Esh-Shuara: 88-89)

O ju musilimanë! Të arrish dashurinë e Allahut është një pozitë madhështore, lumturi e përjetshme dhe jetë e këndshme. Prandaj ai të cilët i është dhënë suksesi për ta arritur atë e ka për detyrë që të jetë i pastër në besim dhe të kryejë adhurim sa më të saktë e të jetë sa më i sjellshëm pra të plotësojë siç duhet besimin e vërtetë dhe të jetë i devotshëm në çdo rast. Allahu i Madhëruar ka thënë: (ky është komentimi i ajetit) "**Me të vërtetë të dashurit (eulijatë) e All-llahut nuk do të kenë frikë e nuk**

do të hidhërohen?" (Junus: 62) Dijeni se pjesë e dashurisë së Allahut është edhe shtimi i kërkimit të faljes dhe përshëndetja e Muhammedit sal-lallahu alejhi ue sellem prandaj bëni sa më shumë salavate dhe përshëndeteni pejgamberin e mëshirës dhe prijësin e udhëzimit siç ju ka urdhëruar Allahu i Madhëruar (ky është komentimi i ajitet) "Me të vërtetë Allahu dhe engjëjt e Tij e lavdërojnë Pejgamberin. O ju që keni besuar, lavdërojeni atë (duke bërë salavate për të) dhe përshëndeteni me selam." (El-Ahzab: 56)

www.alharamainonline.org

AMANETI

Shejhu: Ali Abdurrahman El-Hudhejfi

15/7/1424H

Falenderimi i takon Allahut, të Mençurit, të Gjithëdijshmit, Mbretit, të Shenjit, të Pastërtit, Siguruesit, Mbikqyrësit, Krenarit, Mbizotëruesit, të Madhëruarit. I lartësuar është Allahu nga ajo që i mveshin. Ai i krijoj krijesat që ta adhurojnë. Ai nuk pyetet për çfarë vepron por gjithçka tjetër veç Tij pyetet. Atë e lavdëroj dhe falenderoj për mirësitë që ka dhënë, Ai është ashtu siç e ka lavdëruar vetë veten e Tij. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër përvëç Allahut, Një e i pashoq dhe dëshmoj se Muhammedi është rob dhe i dërguari i Tij, atë e përzgjodhi Zoti i tij, i zbriti dritën e qartë dhe e udhëzoi në rrugën e drejtë. O Allah! Fale dhe përshëndete robin dhe të dërguarin Tënd, Muhammedin, familjen dhe të gjithë shokët e tij.

Allahu i Madhëruar ka thënë: (Ky është komentimi i ajetit) "Ne u ofruam amanetin (obligimet) qiejve, tokës dhe maleve, e ato nuk pranuan ta marrin përsipër atë e u frikësuan prej tij, ndërsa njeriu atë e mori mbi vete. Me të vërtetë ai ishte i padrejtë (ndaj vetes së tij) dhe i padijshëm. (Njeriu e mori përsipër) Kështu që All-llahu të ndëshkojë hipokritët dhe hipokritet, idhujtarët dhe idhujtaret, e t'i fali besimtarët dhe besimtaret. Dhe All-llahu ishte falës e mëshirues." (El-Ahzab: 72-73) Një peshë e rëndë, detyrë e madhe dhe çështje e rrezikshme iu ofrua qiejve, tokës dhe maleve por ato u drodhën dhe nuk pranuan që ta mbanin atë duke u frikësuar nga ndëshkimi i Allahut. Pastaj ai amanet iu paraqit Ademit alejis-selam i cili e morri përsipër mbajtjen e tij. "Me të vërtetë ai ishte i padrejtë (ndaj vetes së tij) dhe i padijshëm." Pra njeriu i cili nuk e mban amanetin është i padrejtë dhe i padijshëm e jo Ademi alejis-selam. Ibn Abbasi (Allahu qoftë i kënaqur prej të dyve!) ka thënë: *Amaneti janë detyrat të cilat Allahu ia paraqiti qiejve, tokës dhe maleve që nëse do t'i kryenin Ai do t'i shpërbiente e në rast të kundërt do t'i ndëshkonte. Ata nuk e pëlqyen një gjë të tillë dhe u frikësuan, pa kundërshtuar kështu Zotin e tyre por duke e madhëruar fenë e Allahut.*

Hasen El-Basri (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: *Ato (detyrat) iu paraqitën shtatë qiejve të zbuluar me yje dhe engjëjve që mbajnë Arshin dhe iu tha: A do ta mbani amanetin dhe gjithë çka lidhje me të? Thanë: Çfarë ka në të? Iu tha: Nëse e plotësoni do të shpërbileheni e nëse nuk e plotësoni do të ndëshkoheni. Thanë: Jo. Pastaj iu paraqitën shtatë tokave. Iu tha: A do ta mbani amanetin dhe gjithë çka lidhje me të? Thanë: Çfarë ka në të? Iu tha: Nëse e plotësoni do të shpërbileheni e nëse nuk e plotësoni do të ndëshkoheni. Thanë: Jo. Pastaj iu paraqitën maleve të cilët përsëri nuk pranuan.*

Amaneti përfshin gjithë detyrat e Sheriatit, të drejtat e Allahut dhe të njerëzve, kush i plotëson ato shpërbilehet e kush i lë pas dore ndëshkohet. Imam Ahmed, Bejhakiu dhe Ibn Ebi Hatim transmetojnë nga Abdullah ibn Me'udi (Allahu qoftë i

kënaqur prej tij!) se ka thënë: *Namazi është amanet, abdesi është amanet, peshimi është amanet, matja është amanet.* Dhe përmendi disa gjëra të tjera. *Dhe më e madhja prej tyre janë porositë.* Ebu Darda (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) ndër të tjera ka thënë: *Larja pas xhunubllékut është amanet.* Prandaj kush ka si cilësi të tij besnikërinë e mbajtjen e amanetit ai e ka plotësuar fenë e tij e kush e humbet këtë cilësi ai e ka hedhur tej fenë. Transmeton Tabarani prej Ibn Umerit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se Muhammedi alejhis-selam ka thënë: "*Nuk ka bësim ai i cili nuk ka amanet.*" Ndërsa Ahmedi, Bezzari dhe Tabarani transmetojnë prej Enesit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se Muhammedi alejhis-selam ka thënë: "*Nuk ka bësim ai i cili nuk ka amanet dhe nuk ka fe ai i cili nuk ka besë.*" Prandaj besnikëria dhe mbajtja e amanetit ishte cilësi e pejgamberëve dhe njerëzve të mirë. Allahu i Madhëruar ka thënë për Nuhun, Hudin dhe Salihun alejhmus-selam se secili prej tyre i tha popullit të tij: (ky është komentimi i ajetit) "**Unë jam për ju i dërguar, besnik.** Prandaj **frikësojuni** (dënimit të) **All-llahut dhe bindmuni mua.**" (Esh-Shuara: 107-108) Sa më shumë të pakësohenet besnikëria aq më shumë pakësohen pjesët e besimit siç ka transmetuar Muslimi nga Hudhejfe (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se Muhammedi alejhis-selam ka thënë: "*Amaneti zbriti në rrënjet e zemrave të burrave* (pra në mes të tyre) *pastaj zbriti Kur`ani dhe mësuan prej Kur`anit dhe prej Sunnetit.*" Pastaj foli për humbjen e amanetit i cili do të hiqet pak nga pak nga zemrat e njerëzve e së fundi morri një guriçkë e hodhi mbi këmbë e tha: "*Pastaj njerëzit vazhdojnë të lidhin besa por pothuajse asnjëri nuk e mban amanetin. Derisa të thuhet: Tek filan fis është një burrë besnik. E derisa të thuhet për ndonjë person: Sa i mirë, sa i llogjikshëm është. Por në zemrën e tij nuk do të ketë besim as sa një grimcë.*" Kuptohet nga hadithi se personi nëse me qëllim do ta humbasi besnikërinë dhe amanetin duke lënë pas dore detyrat e fesë e duke mashtruar në të drejtat e robërve ka për tu ndëshkuar me heqjen e besnikërisë prej zemrës së tij. Allahu nuk mund ta heqi besnikërinë nga zemra e dikujt pa shkak ashtu siç ka thënë vetë Allahu i Madhëruar: (ky është komentimi i ajetit) "**E kur ata u shhangën** (nga e vërteta), **All-llahu i shhangu zemrat e tyre, e All-llahu nuk e udhëzon popullin e prishur.**" (Es-Saff: 5) Fundi i hadithit tregon se amaneti është vetë besimi, ai është vetë feja dhe detyrat e saj, Teuhidi është amanet, namazi është amanet, zekati është amanet, agjërimi është amanet, haxhi është amanet, ruajtja e lidhjeve farefisnore është amanet, urdhërimi për të mirë është amanet, ndalimi nga e keqja është amanet, pasuria është amanet prandaj mos e përdor atë për harame, syri është amanet prandaj mos shiko me të aty ku ka ndaluar Allahu, dora është amanet, organi seksual është amanet, barku është amanet prandaj mos ha atë që nuk të lejohet, fëmijët janë amanet tek ty prandaj mos e lë pas dore edukimin e mirë të tyre, gratë janë amanet tek burrat prandaj mos i shpërdoro të drejtat e tyre, të drejtat e burrave ndaj grave janë amanet, të drejtat e robërve janë amanet prandaj mos i shpërdoroni ato. Allahu i Madhëruar ka premtuar shpërbirim të madh për ata që mbajnë amanetin dhe i japid atij të drejtën e duhur. Allahu i Madhëruar ka thënë: (ky është komentimi i ajetit) "**Dhe ata të cilët me kujdes i ruajnë amanetet dhe premtimin e dhënë. Dhe ata të cilët janë të kujdeshëm për namazet e tyre. Të tillët janë ata trashëgimtarët. Të cilët e trashëgojnë Firdeusin, aty janë të përjetshëm.**" (El-Mu'minun: 8-11) Nga Ebu Hurejre (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) transmetohet se Pejgamberi alejhis-selam ka thënë: "*Më garantoni* (se do t'i

ruani) *gjashtë gjëra t`ju garantoj Xhennetin.*" Ebu Hurejre tha: Cilat janë ato (gjashtë gjëra) o i Dërguari i Allahut? Tha: "*Namazi, zekati, amaneti, organi seksual, barku dhe gjuha.*" El-Mundhiri ka thënë për selen din e hadithit se nuk ka ndonjë problem.

Mosmbajtja e amaneteve dhe lënia pas dore e detyrave të fesë shkakton mangësi dhe shkatërrim të përfitimeve të njerëzve, e bën jetën të hidhur, përfitimet personale dhe shoqërore i çon drejt rrezikut dhe shkatërrimit, prish mbarrëvajtjen dhe e çon gjithësinë drejt shkatërrimit. Kur Muhammedi sal-lallahu alejhi ue sel-lem u pyet se kur do të ndodhë Kijameti tha: "*Kur të humbasì amaneti prite Kijametin.*" Prandaj frikësojuni Allahut o njerëz dhe mbajini siç duhet amanetet, kryejini detyrat dhe largojuni harameve. Allahu i Madhëruar ka thënë: (Ky është komentimi i ajetit) "**Dhe ata të cilët me kujdes i ruajnë amanetet dhe premtimin e dhënë. Edhe ata që dëshminë e vet e zbatojnë** (nuk e mohojnë, nuk e fshehin). **Edhe ata që janë të kujdeshëm ndaj namazit të tyre. Të tillët janë të nderuar nëpër Xhennete.**" (El-Mearixh: 32-35)

Frikësojuni Allahu me sinqeritet të plotë dhe bindjuni duke zbatuar urdhërat e Tij dhe duke iu larguar ndalesave të Tij që kështu të fitoni Xhennetin dhe kënaqësinë e Tij. Allahu i Madhëruar ka thënë: (Ky është komentimi i ajetit) "**All-llahu ju urdhëron që t'u jepni amanetin të zotëve të tyre dhe kur të gjykon i mes njerëzve, të gjykon i me drejtësi. Sa e mirë është kjo me të cilën Allahu po ju këshillon. Me të vërtetë Allahu ishte dëgjues, shikues** (i asaj që veproni)." (En-Nisa: 58) Ky ajet ka përfshirë të gjitha llojet e amaneteve e prej më të rëndësishmeve prej tyre janë postet dhe detyrat zyrtare, kush plotëson në to detyrat që ka ndaj Allahut dhe i shërbën muslimanëve duke u plotësuar atyre kërkasat dhe problemet që kanë ai person me të vërtetë që e ka këshilluar veten e tij dhe ka bërë të mira për Ahiretin e tij. Ndërsa kush nuk i kryen siç duhet detyrat që i janë caktuar aty dhe nuk plotëson kërkasat e njerëzve, merr ryshfet ose merr pa të drejtë pasurinë e muslimanëve ai person ka mashtruar veten e tij dhe i ka bërë asaj padrejtësi. Në sahihun e Muslimit transmetohet se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "*Kur Allahu i Madhëruar ditën e Kijametit të grumbullojë të parët dhe të fundit, për çdo mashtrues do të ngrihet një flamur e do të thuhet: Ky është mashtrimi i filanit të birit të filanit.*"

Prej amaneteve më të rëndësishme janë porositë dhe detyrat për të cilat njerëzit të kanë lënë kujdestar. Imam Ahmed dhe Bejhakiu transmetojnë se Ibn Mes'udi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) ka thënë: *Vrasja* (të vritesh) *në rrugë të Allahut i fshin të gjitha gjynahet përvëç amanetit* (që nuk është mbajtur). *Sillet personi ditën e Kijametit dhe i thuhet: Çoje në vend amanetin. Thotë: Si o Zot ndërkokë që dynjaja ka mbaruar. Thuhet: Çojeni në Haujë* (zjarr i nxeh të në Xhehenem). *E çojnë në Haujë dhe amaneti i pambajtur i shfaqet në pamjen që kishte kur iu dha në kujdes e ai e shikon dhe e njeh. Lëshohet pas tij derisa e kap dhe e merr mbi supe e kur mendon se doli* (prej zjarrit) *i bie nga supet e ai lëshohet pas tij përjetësisht.*"

O robërit e Allahut! Allahu i Madhëruar ju ka urdhëruar që të bëni salavate dhe të përshëndesni pejgamberin e Tij të zgjedhur. Ai ka thënë: (ky është komentimi i ajetit) "**Me të vërtetë Allahu dhe engjëjt e Tij e lavdërojnë Pejgamberin. O ju**

që keni besuar, lavdërojeni atë (duke bërë salavate për të) **dhe përshëndeteni me selam."** (El-Ahzab: 56)

www.alharamainonline.org

KËSHILLA

Shejhu: Ali Abdurrahman El-Hudhejfi

22/7/1424H

Falenderimi i takon Allahut, Dëgjuesit, Shikuesit, Njohësit të gjithçkaje i cili ka përfshirë gjithçka me mëshirën e Tij. E falenderoj Zotin tim, tek Ai pendohem dhe i kërkoj falje. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjeter përveç Allahut, të Lartit e të Plotfuqishmit i cili nuk ka shok dhe dëshmoj se Muhammedi është rob dhe i dërguari i Tij. O Allah, fale, përshëndete dhe begatoje robin dhe të dërguarin Tënd, Muhammedin, familjen dhe të gjithë shokët e tij.

Frikësojuni Allahut dhe tregohuni të devotshëm ndaj Tij sepse me të vërtetë të fituarit janë ata që i frikësohen dhe tregohen të devotshëm ndaj Tij. O ju muslimanë, këshilla më e mirë për zemrat dhe pastrimi më i mirë për shpirrat janë ajetet e Kur'anit ose hadithet e të dërguarit të Allahut. Allahu i Madhëruar ka thënë: (Ky është komentimi i ajetit) "Ai është që tek të pashkollarit (arabët) dërgoi Pejgamberin nga mesi i tyre që t'ju lexojë ajetet e Tij, t'i pastrojë ata, t'u mësojë librin dhe mençurinë (Sheriatin) edhe pse më parë ata ishin në një humbje të dukshme." (El-Xhumuh: 2) Dëgjoni dhe hapini zemrat dhe mendoni pak rreth disa fjalëve të pakta të zotërisë së njerëzimit, Muhammedit alejhis-selam, të cilat kanë përbledhur të gjithë fenë islame si dhe gjithë mirësitë e fesë dhe dynjasë. Këto fjalë të pakta nuk kanë lenë asnje mirësi pa përfshirë dhe nuk kanë lenë asnje të keqe veçse kanë paralajmëruar prej saj. Pejgamberi ynë alejhis-selam fliste me fjalë madhështore, përbledhëse por të pakta të cilat përbananin kuptime të shumta, të dobishme dhe madhështore. Ndodh që një fjalë e vetme e tij të përfshijë të gjitha mësimet e Islamit, prej këtyre fjalëve është: "*Bamirësia* (Ihsani) është ta adhurosh Allahun sikur ti e shikon Atë..." Transmetoi Muslimi nga hadithi i Umerit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!).

Ai gjithashtu ka thënë: "*Mirësia* është çdo gjë tek e cila të qetësohet vetja dhe zemra ndërsa gjynahu është çdo gjë që ndikon tek vetja, lëviz në gjoks dhe urren që ta dinë njerëzit, edhe nëse për të të japid fetua njerëzit."

Transmeton Ahmedi dhe Muslimi një pjesë të tij. Prej fjalëve të tij të dobishme dhe të begatshme është edhe: "*Feja* është këshillë, *feja* është këshillë, *feja* është këshillë."

Thamë: Për kë o i Dërguari i Allahut? Tha: "*Për Allahun, për librin e Tij, për të Dërguarin e Tij, për prijësat e muslimanëve dhe për njerëzit e thjeshtë.*" Transmetoi Muslimi nga hadithi i Temijm Ed-Dari (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!). Ky hadith tregon se feja është vetëm këshillë prandaj kush e ka këshillimin cilësi të tij me të vërtetë që e ka plotësuar fenë ndërsa kujt i është privuar këshillimi, atij i është mangësuar feja në vartësi me mangësinë që ka në këshillim. Këshillë do të thotë: Të plotësosh të drejtat e atij që këshillon duke e dashur me sinqueritet atë, të drejtat janë fjalë, vepra dhe dëshira të zemrës. Këshillimi është prej cilësive të pejgamberëve, të dërguarve dhe të besimtarëve ndërsa mashtrimi dhe ngritja e kurtheve është prej cilësive të kasfirëve

dhe munafikëve. Allahu i Madhëruar duke përmendor Nuhin alejhis-selam ka thënë: (Ky është komentimi i ajetit) "Unë ju kumtoj juve shpalljet e Zotit tim, ju këshilloj dhe unë di nga Zoti im çka ju nuk dini." (El-A`raf: 62) dhe ka thënë për Hudin alejhis-selam: (Ky është komentimi i ajetit) "(Jam dërguar) Që t'ju komunikoj shpalljet e Zotit tim dhe unë jam këshillues besnik për ju." (El-A`raf: 68) dhe ka thënë për Salihun alejhi-selam: (Ky është komentimi i ajetit) "**O populli im, unë ju komunikova dërgesën e Zotit tim, ju këshillova sa munda, por ju nuk i doni këshilluesit.**" (El-A`raf: 79) dhe ka thënë për Shuaibin alejhis-selam: (Ky është komentimi i ajetit) "**O populli im, vërtet unë ju komunikova porositë e Zotit tim, ju dhashë këshilla, e si të brengosem për një popull jobesimtar.**" (El-A`raf: 93) Allahu i Madhëruar ka thënë: (Ky është komentimi i ajetit) "Nuk është ndonjë mëkat për të dobëtit, as për të sémurët, e as për ata që nuk kanë me çka të preqatiten, kur ata këshillojnë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij..." (Et-Teube: 91) Nga Xheriyr ibn Abdilah (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) transmetohet se ka thënë: *I dhashë besën të Dërguarit të Allahut sal-lallahu aleji ue sel-lem për të falur namazin, për të dhënë zekatin dhe për të këshilluar çdo musliman.* Transmeton Buhariu dhe Muslimi. Nga Ebu Hurejre (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) transmetohet se pejgamberi alejhis-selam ka thënë: "*Të drejtat e muslimanit ndaj muslimanit janë gjashtë: Nëse e takon atë jepi selam, nëse të thërret përgjigjiu atij, nëse të kërkon këshillë këshilloje atë, nëse teshtin dhe falenderon Allahun thuaji atij jerhamukallah, nëse sémuret vizitoje dhe nëse vdes pusoje xhenazen e tij.*" Transmeton Muslimi. Nga Xhubejr ibn Mut'im (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) transmeton se Pejgamberi alejhis-selam ka thënë: "*Tre gjëra nuk mund t'i ketë smirë zemra e muslimanit: veprimi i punëve vetëm për hir të Allahut* (singjeriteti), *këshillimi i prijësave dhe qëndrimi bashkë me xhematin e muslimanëve.*" Transmeton Ahmedi dhe Ibn Hibbani. Kuptimi i hadithit është se këto tre gjëra e rregullojnë zemrën dhe e pastrojnë atë nga mashtrimi, smira dhe nga çdo gjë tjeter e keqe. Njerëzit më të mirë të këtij populli janë ata që prej cilësive të tyre kanë edhe këshillën për Allahun, librin e Tij, për të Dërguarin e Tij, për prijësat e muslimanëve dhe për njerëzit e thjeshtë. Ebu Bekër El-Muzeni (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: *Ebu Bekri* (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) *nuk kishte më shumë se sahabët e tjerë as agjërim e as namaz por kishte diçka në zemrën e tij më shumë se të tjerët. Kishte në zemrën e tij dashurinë për hir të Allahut dhe këshillën për krijesat e Tij.* Ibnul-Mubarek (Allahu e mëshiroftë!) u pyet se cila është puna më e mirë dhe tha: *Këshilla për hir të Allahut.* Ma`mer (Allahu e mëshiroftë ka thënë) ka thënë: *Njeriu që të këshillon ty më mirë është ai që i frikësohet Allahut për ty.* Disa prej selefëve kanë thënë: *Kush e këshillon vëllanë e tij vetëm për vetëm, ai me të vërtetë e ka këshilluar ndërsa kush e këshillon atë përparrë njerëzve me të vërtetë që e ka poshtërruar.* Kuptimi i këshillës për Allahun është adhurimi i Tij pa i shoqëruar Atij askënd, duke qenë i singertë në atë adhurim dhe duke pasuar Muhammedin sal-lallahu aleji ue sel-lem, duke iu nënshtruar Atij dhe njëkohësisht duke e dashur Atë. Duke mos shoqëruar ndonjë tjeter veç Tij në lutje, në kurban, në zotim, në kërkimin e ndihmës, në kërkimin e mbrojtjes, në mbështetje, në shpresë, në frikë dhe në çdo lloj tjeter të adhurimit duke iu përbajtur thënies së Allahut të Madhëruar: (Ky është komentimi i ajetit) "**Adhurojeni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asnje send...**" (En-Nisa: 36) Ai gjithashtu ka thënë: (Ky është

komentimi i ajetit) "Dhe se vërtet xhamitë janë vetëm për (të adhuruar) Allahun prandaj mos adhuroni në to askënd tjetër me Allahun!" (El-Xhinn: 18) Këshilla për Allahun e Madhëruar është besimi në cilësitë e Tij ashtu si e ka cilësuar Ai veten e Tij dhe ashtu si e ka cilësuar Atë i Dërguari i Tij alejhis-selam duke mos i krahasuar ato me cilësitë e krijesave si dhe duke mohuar prej Tij çdo gjë që nuk i përshtatet Atij por pa mohuar cilësitë e Tij të vërteta. Duhet të besojmë se vetëm Ai është Krijuesi dhe drejtuesi i gjithësisë në dynja dhe Ahiret duke zbatuar kështu thënien e Tij: (Ky është komentimi i ajetit) "**Ja, vetëm Atij i takon krijimi dhe sundimi...**" (El-A`raf: 54) Duhet që të afrohemë tek Ai duke vepruar çdo detyrë dhe çdo gjë të pëlqyer dhe duhet të largohemi nga çdo haram. Kush i kryen këto detyra ndaj Zotit të tij me të vërtetë që ka këshilluar për Krijuesin e tij. Hasen El-Basri transmeton në hadithin mursel se Muhammedi alejhis-selam ka thënë: "*Sikur ndonjëri prej jush të kishte dy robër, njëri prej tyre i bindej atij kur e urdhëron, e mbante amanetin dhe këshillonte për të kur ai mungonte. Ndërsa tjetri e kundërshtonte kur ai e urdhëron për diçka, nuk e ruante amanetin dhe mashtronte kur i zoti i tij mungonte. A janë këta dy robër njësoj?*" Thanë: Jo. Tha: "*Edhe ju kështu jeni tek Zoti juaj.*" Transmeton Ibn Ebi Dunia. Ebu Umame (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) transmeton prej Muhammedit alejhis-selam se Allahu i Madhëruar ka thënë: "*Gjëja më e mirë me të cilën më adhuron robi Im është këshilla për Mua.*" Transmeton Ahmedi. Prej këshillës për Allahun është të duash atë që e do Allahu prej fjalëve dhe veprave dhe të urresh atë që Allahu e urren. Disa prej dijetarëve kanë thënë: Këshilla është t'i japësh rëndësi me zemër atij që këshillon e kjo është dy llojshe: Njëra prej tyre është detyrë e tjetra është e pëlqyer. Këshilla e detyruar për Allahun e Madhëruar është interesi i madh që tregon personi duke e dashur Allahun gjatë zbatimit dhe kryerjes së detyrave ndaj Tij si dhe largimi nga ato që Ai i ndaloi. Ndërsa këshilla e pëlqyer është dhënia përparesi dashurisë së Allahut ndaj dashurisë për veten e kjo duket nëse personi ka përpresa dy çështje, njëra ka përfitim për veten ndërsa tjetra është punë për hir të Allahut, atëherë i jep përparesi asaj që është për hir të Allahut. Ndërsa këshilla për librin e Allahut është ta duash atë, madhërimi i tij, dëshira për ta kupuar atë, dhënia rëndësi mësimit të tij sipas mundësisë dhe suksesit që të jep Allahu, vazhdimësia në leximin e tij, sjellja sipas moralit të tij, gjykimi tek ai dhe thirrja e njérëzve për ta mësuar atë dhe për tua mësuar atë të tjerëve. Ndërsa këshilla për të dërguarin e Allahut është bindja ndaj urdhërave të tij, largimi nga ato që ai ndaloi, besimi në atë që ai na lajmëron, adhurimi i Allahut sipas Sheriatit të tij, ndihmesa e Sunnetit të tij, kujdesi për udhëzimin që ai solli dhe shpërndarja e tij si dhe urrejtja e atyre që e urrejnë Sunnetin e tij, pasimi i tij shfaqurazi dhe fshehtazi, dashuria e tij më shumë sesa vetja, pasuria, familja dhe fëmijët, kundërpërgjigjia që dijetarët i bëjnë pasimit të epsheve që çojnë në humbje, ruajtja e Sunnetit dhe mbrojtja e tij. Ndërsa këshilla për prijesat e muslimanëve shprehet në lutjen për mirësinë e tyre dhe shpresa që ata të rregullohen, të duash drejtësinë e tyre dhe bashkimin e njérëzve rrëth tyre, përhapja e të mirave të tyre dhe urrejtja e përmendjes së të këqijave të tyre, bindja ndaj tyre në të mirë, mos dalja kundër tyre qoftë me fjalë ose me vepra si dhe urrejtja e atyre që duan të dalin kundër tyre, këshilla e tyre me mënyrën më të mirë në ato çështje që i sjellin mirësi popullit në dynja dhe Ahiret, këshillimi i tyre të bëhet me butësi, mençuri, për hir të Allahut, mos të luteimi kundër tyre. Ndërsa këshilla për njérëzit e

thjeshtë plotësohet duke dashur për ta atë që do edhe për vete, të urresh për ta atë që urren edhe për vete, të mëshirosh të voglin, të respektosh të madhin, ndihma e tyre në të vërtetën dhe mësimi i tyre, urdhërimi i tyre për të mirë dhe ndalimi i tyre nga e keqja, largimi i së keqes dhe rrezikut që i kërcënnon ata. Nga rreziqet dhe të këqijat më të mëdha që po ndodhin mbi këtë popull janë veprimet shkatërruese, terroristë që e bënë të lejuar derdhjen e gjakut të ndaluar, shkatërrimin e pasurive, frikësimin e njerëzve të qetë dhe të cilat u bënë shkak për prishjen e rendit dhe qetësisë. Këto veprime e kanë origjinën nga mendimi i tekfirit (nxjerrjes së muslimanëve nga feja) dhe i Hauarixhëve i cili nuk sjell veçse shkatërrime në tokë. Këtë mendim Muhammedi alejhis-selam e ka përqmuar. Prej këshillës për njerëzit e thjeshtë muslimanë është largimi i këtij mendimi prej tyre dhe paralajmërimi i muslimanëve prej tij si dhe lajmërimi i organeve përkatëse për ata persona që pregatiten për shkatërrime të tilla që kështu ata të gjejnë shpërblimin e merituar dhe që të largohet rreziku i gjakderdhjet të mëtejshme si dhe i shkatërrimit të pasurive. Nuk lejohet fshehja e tyre në asnje mënyrë. Prej këshillës për muslimanët është mbrojtja e tyre nga çdo e keqe në fenë dhe dynjanë e tyre. Djeni se Hauarixhët shkatërrojnë fenë dhe dynjanë. Allahu i madhëruar ka thënë: (Ky është komentimi i ajetit) "**O ju që besuat, përgjigjuni (thirrjes së) Allahut dhe të Dërguarit kur ai (i Dërguari) ju fton për atë që ju jep jetë, dhe djeni se Allahu ndërhyjn mes njeriut dhe zemrën së tij dhe (djeni) se ju do të toboheni tek Ai.**" (El-Enfal: 24)

O ju muslimanë! Tregohuni të devotshëm ndaj Allahut dhe frikësojuni asaj dite kur do të ktheheni tek Allahu, pastaj secili do të shpërblehet sipas veprave që ka bërë dhe askujt nuk do t'i bëhet padrejtësi. Zbatojeni porosinë që Muhammedi alejhis-selam ia dha Muadhit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!): "*Frikësoju Allahut kudo që të jesh, pasoje të keqen me një të mirë që ta fshijë atë dhe sillu me njerëzit me moral të mirë.*" Për çdo të mirë ka shpërblim dhe për çdo të keqe ka ndëshkim. Zoti juaj është mbikqyrës për punët e gjithkujt, ua numëron punët kriesave pastaj i gjykon për to dhe në një hadith kudsi thotë: "*O robërit e Mi, ato janë punët tuaja, ua llogaris ato e pastaj ju shpërblej për to. Kush gjen mirë le të falenderojë Allahun e kush gjen diçka tjetër* (jo të mirë) *mos të qortojë veçse veten e tij.*" Çdo njeri do ta marrë librin e (punëve të) tij ose me të djathtën ose me të majtën. Allahu i Madhëruar ka thënë: (Ky është komentimi i ajetit) "*Secilit njeri ia kemi ngjeshur në qafë fluturaken (librin për punën) e tij, e në ditën e Kijamitet Ne do t'i nxjerrim atij një libër të hapur.* (Do t'i thuhet) Lexoje librin tënd, mjafton të jesh sot vetë llogaritës i vvetvetes." (El-Isra: 13-14) Pregatituni për këtë ditë me çdo gjë të mirë që keni mundësi. "**Me të vërtetë Allahu dhe engjëjt e Tij e lavdërojnë Pejgamberin. O ju që keni besuar, lavdërojeni atë** (duke bërë salavate për të) **dhe përshëndeteni me selam.**" (El-Ahzab: 56)

www.alharamainonline.org

BEGATITË E ALLAHUT NUK NUMËROHEN

Shejhu: Ali Abdurrahman El-Hudhejfi

29/7/1424

Falenderimet i takojnë Allahut, Krijuesit të gjithçkaje, Bujarit i cili i ka përsosur begatitë e Tij ndaj krijesave. E flenderoj Zotin tim, tek Ai pendohem dhe Atij i kërkoj falje. Dëshmoj se Nuk ka të adhuruuar tjetër përvèç Allahut, Mbretit të drejtë dhe të mençur e dëshmoj se Pejgamberi ynë, Muhammedi është rob dhe i dërguar i Tij. O Allah, fale, mëshiroje dhe begatoje robin dhe të Dërguarin Tënd, Muhammedin, familjen dhe shokët e tij.

Frikësojuni Allahut në fshehtësi e shfaqurazi e dijeni se devotshmëria është gjëja më e mirë që mund të veproni e që mund të mblidhni për botën tjetër.

O ju muslimanë! Përkujtoni mirësitë që ju ka dhënë Allahu, të dukshme apo të fshehta qofshin ato, falenderojeni Atë pér to që t'ju shtojë prej tyre dhe t'jua ruajë ato. Mirësitë e Allahut ndaj jush nuk mund të numërohen. Allahu i madhëruar ka thënë: (ky është komentimi i ajitet) **“Edhe nëse përpinqeni t'i numëroni begatitë e All-llahut, nuk do të mund të arrini t'i përcaktioni (numëroni) ato. Me të vërtetë All-llahu shumë fal dhe mëshiron.”** (En-Nahl: 18) A munden njerëzit të numërojnë frymëmarrjen apo hapjet dhe mbylljet e syrit? Nuk do të munden. Begatitë janë më shumë sesa frymëmarrjet dhe lëvizjet e syrit të cilat nuk janë veçse disa prej begative që Allahu i ka dhuruar krijesave të Tij.

O ju muslimanë! Allahu me bujarinë e Tij ju ka dhuruar në këtë vend (vendin e dy Haremeve) mirësi të shumta e begati të cilat jo vetëm që nuk mundeni t'i numëroni por dhe nuk mundeni t'i falenderoni. Ai na ka veçuar me mirësi që nuk i janë dhënë askujt tjetër prandaj duhet që të kujdesemi, t'i vlerësojmë dhe të falenderojmë Allahun pér to shfaqurazi dhe fshehtazi. Prej këtyre mirësive është se Ai na ka shpëtuar prej partive që therren mes njëra-tjetrës si dhe prej rrymave dhe mendimeve të dëmshme, ndikimi i keq i së cilave është i dukshëm në ato vende ku janë shfaqur. Në vendin tonë nuk ka vend pér ato parti sepse feja e banorëve të kësaj mbretërie është Islami madhështor. I cili i ka ndaluar grupacionet dhe pasimin e epsheve. Allahu i Madhëruar ka thënë: (ky është komentimi i ajitet) **“Dhe kapuni që të gjithë pas litarit (fesë dhe Kur'anit) të All-llahut, e mos u përqan! Përkujtojeni mirësinë e All-llahut ndaj jush, kur ju (para se ta pranonit fenë islame) ishit të armiqësuar, e Ai bashkoi zemrat tuaja dhe ashtu me mirësinë e Tij arrijtë të bëheshit vëllezër.”** (Ali Imran: 103) dhe ka thënë: (ky është komentimi i ajitet) **“Vërtet ata që e përçanë fenë e tyre dhe u ndanë në grupe, ti (Muhammed) nuk ke kurrfarë përgjegjësie pér ta.”** (El-En`am: 159) Islami është e vërteta dhe e vërteta bashkon dhe nuk përqan, mban drejtësi e nuk bën zullum, rregullon e nuk prish, mëshiron e nuk tregohet e ashpër. Muslimani përkrah të vërtetën dhe ata që e zbatojnë atë, ai përpinqet me çdo mënyrë të mbrojë tokën mbi të cilën zbatohet e vërteta. Dihet qartë se qëllimi kryesor i muslimanit është mbrojtja e Islamit, ai e ka

për detyrë që të zgjedhë përgjegjës pér zbatimin e Sheriatit dhe pér të mbrojtur të drejtat e fesë. Nëse dihet se kjo është diçka e qartë tek muslimanët atëherë nuk ka vend pér partitë e ndryshme tek ne sepse secila prej tyre ndjek qejfet e saj dhe një gjë e tillë e dobëson umetin dhe i heq vëmendjen prijësit nga çështjet e rëndësishme të popullit. Gjendja më e mirë pér njerëzit është atëherë kur feja është e fortë në zemrat e popullit dhe kur prijësi i tyre është i fortë në zbatimin e ligjeve. Edhe nëse feja në zemrat e disa njerëzve është e dobët por prijësi i tyre është i fortë përsëri punët ecin mirë e shkatërrimtarët janë të pafuqishëm. Falenderimet i takojnë Allahut që prijësi i këtij vendi dhe zëvendësit e tij janë të fuqishëm. Pér këtë gjithashtu ka ndihmuar edhe ndihma e përbashkët mes drejtuesve dhe njerëzve të thjeshtë duke zbatuar kështu udhëzimet e fesë islame e cila urdhëron pér bashkim rreth së vërtetës dhe largimin nga përçarja. Ne jeni në ndjekje të besimit të muhaxhirëve, ensarëve dhe atyre që i pasuan në rrugën e drejtë. Allahu i Madhëruar pér ta ka thënë: (ky është komentimi i ajetit) **“Dhe ata që besuan, emigruan dhe luftuan pér rrugën e All-lahut, dhe ata që strehuan dhe ndimuan, janë besimtarë të vërtetë. Atyre u takon falje (e mëkateve) dhe furnizim i nderuar.”** (El-Enfal: 74)

Falenderojmë Allahun e Madhëruar i cili na bëri muslimanë, Islami është mirësia më e madhe të cilën Allahu ia jep robërve. Allahu i madhëruar ka thënë: (ky është komentimi i ajetit) **“Sot përsosa pér ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush begatinë Time dhe zgjodha pér ju Islamin fe.”** (El-Maide: 3)

Muslimani edhe pse është i udhëzuar në rrugën e drejtë megjithatë ai tregon frikërespekt dhe thjeshtësi ndaj Zotit të tij, nuk i nënçmon robërit e Allahut dhe nuk i tejkalon kufijtë e Tij. Islami i ka ndaluar atij padrejtësinë dhe armiqësinë qoftë edhe me jomuslimanët. Feja e tij e urdhëron atë pér drejtësi, bamirësi, mëshirë dhe vepra të mira me njerëzit. Prej mirësisë që mund t'i bëhet njeriut është ta ftosh atë në rrugën e Allahut me mençuri, këshillim të mirë dhe me rrugën e lejuar me të cilën ndihmohet e vërteta dhe shkatërrohet e kota. Allahu i Madhëruar ka thënë: (ky është komentimi i ajetit) **“Ti (Muhammed) thirr pér në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe debato me ta (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira. Zoti yt është Ai që e njeh më së miri atë që është larguar nga rruga e Tij dhe Ai njeh më së miri të udhëzuarit.”** (En-Nahl: 125)

Islami është më i shtronjtë pér muslimanin sesa vetja, familja, pasuria dhe fëmijët e tij. Ndodh që të humbasi pasurinë, pozitën, të përballet me vështirësi por ai është i lumtur nëse ka shpëtuar feja e tij. Mus'ab ibn Umejri (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) ishte i shpërndigjurgjulli i parë pér në Medine. Atë e dërgoi Muhammedi sal-lallahu alejhi ue sel-lem pér të thirrur në Islam e pér t'u mësuar të tjerëve Kur'anin. Kishte qenë një djalosh, i pasur e me gjithë të mirat por kur pranoi Islamin nëna e tij e privoi nga pasuria. Kur Muhammedi alejhis-selam e pa me ngjyrë të ndryshuar dhe me rroba të grisura i lotuan sytë e i erdhi keq pér vuajtjet që ai kishte kaluar por ai ishte i pasur me besimin e tij. Ra dëshmor në luftën e Uhudit.

Prej mirësive të këtij vendi është Shtëpia e Allahut (Ka'bja). Ajo është kibla e muslimanëve dhe prehja e zemrave të tyre. Allahu e bëri atë shkak të sistemimit të dobive të njerëzve. Allahu i madhëruar ka thënë: (ky është komentimi i ajetit) **“All-lahu e bëri Ka`ben, shtëpinë e shenjtë, në shërbim pér njerëzit ...”** (El-Maide: 97) Komentuesit e Kur'anit kanë thënë: Shtëpia e shenjtë është është qendra e jetës

dhe fesë së tyre. Aty ata rregullojnë fenë dhe dynjanë e tyre. Në të sigurohet i frikësuari, ndihmohet i pamunduri, fiton tregtari dhe adhuron adhuruesi.

Prej mirësive të këtij vendi është xhamia e të Dërguarit të Allahut, faltorja e fundit e profetëve. Allahu i Madhëruar, namazin në të e ka bërë më të mirë se njëmijë namaze në ndonjë xhami tjeter përveç asaj në Meke. Në tokën e Medines së këndshme është banesa e të Dërguarit të Allahut e asnjë varr profeti tjeter përveç tij nuk njihet.

Prej mirësive të këtij vendi janë gjykatat e Sheriatit të cilat gjykojnë sipas Sheriatit në çështjet e pasurisë, gjakut, ndëshkimit, mosmarrveshjeve e gjithçkaje tjeter. Para tyre është i barabartë mbreti dhe ai që është poshtë tij.

Prej mirësive që Allahu i ka dhënë këtij vendi është qetësia dhe siguria e qëndrueshme në të cilën njerëzit kanë të sigurt jetën, pasurinë, përfitimet vetiakë dhe fetare. Për këtë gjë ky vend merret si shembull i mirë në gjithë botën dhe ia ka kaluar çdo vendi tjeter. Ndërsa terrorizmi dhe shkatërrimet që kanë ndodhur kohët e fundit e kanë originën në mendime të dëmshme, të ardhura (nga të tjerët) që janë përballuar nga drejtuesit e këtij vendi dhe dijetarët me guxim dhe janë bllokuar e ndaluar. Këto mendime tekfiri janë munduar të luftojnë programet tona mësimore që kur janë vendosur. Programet tona mësimore kanë nxjerrë kuadro të cilët i shërbejnë fesë dhe vendit të tyre, që i duan të mirën njerëzimit por çdo rregull ka edhe përjashtime dhe secili i merr gjynahet përsipër e askush nuk jep llogari për të tjerët. Siguria e këtij vendi nuk ka për t'u ndikuar nga shkatërrimet e këtij grupi të shtrembër, ajo nuk është veçse një fluskuq që shpejt do të çahet.

Prej mirësive të këtij vendi është edhe qëndrueshmëria politike pas së cilës gjithçka bëhet e qëndrueshme, lulëzon jeta, zhvillohet ndërtimi dhe kultura, pasuritë shfrytëzohen në dobi të njerëzve, nderohet feja dhe shuhen fitnet.

Prej mirësive është sigurimi i të drejtave të njeriut nën hijen e Sheriatit islam. Armiqtë e këtij vendi flasin se tek ne ka shkelje të të drejtave të gruas, ata janë kundër zbatimit të dënimive sipas Sheriatit duke pretenduar se ato janë në kundërshtim të të drejtave të njeriut. Sa fjalë dhe qëllimi i keq që është.

Gruaja në këtë vend, qoftë ajo nënë, vajzë, motër, hallë, teze, vajzë vëllai, vajzë motre ose bashkëshorte gjithmonë e gjen të drejtat e saj prej të afërmve, ia plotësojnë ato si detyrë islamë, me bindje dhe kënaqësi. Edhe bashkëshorti plotëson nevojat e gruas që ajo të mos ketë nevojë për asnjë tjeter. Në këtë vend gruaja gjen të gjitha të drejtat e shtetasit, jeta e saj është e nderuar dhe gjen punë të ndryshme që nuk janë në kundërshtim me rregullat e fesë dhe moralit. Punën e madhe që bën gruaja në shtëpi dhe shoqëri për edukimin e brezave nuk mund ta bëjë as shërbëtori e as ndonjë tjeter. Gjendja e gruas në vendin tonë është shumë më e mirë sesa në vendet e tjera. Ndërsa me atë që thuhet se të drejtat e saj humbasin në këtë vend, armiqtë e këtij vendi nuk kanë për qëllim veçse që ajo të dalë jashtë vlerave të fesë dhe moralit të saj islam si dhe të jetë një plaçkë me çmim të lirë. Por gruaja në shoqërinë tonë sa më e madhe të jetë mosha e saj e sa më i dobët të jetë trupi i saj, aq më shumë respektohet dhe mëshirohet. Ndërsa tek ata të cilët thërrasin për të drejtat e gruas a nuk i është marrë asaj nderi? A nuk është ajo që më shumë jep prej nderit të saj sesa merr? A nuk e zbojnë prej shtëpisë pasi mbush moshën e martesës duke e hedhur në jetën e vështirë mes ujqërve të njerëzimit e kështu ajo mbështetet tek ujqërit për të zëvendësuar atë që humbi prej afrimitet njerëzor, ndërsa kur nuk ka

më mundësi që të japi asgjë e çojnë nëpër azile ku ajo ekziston, por është e humbur, është e gjallë, por si e vdekur. A mos vallë këto janë të drejtat e gruas? Ai që e ka shtëpinë prej xhami nuk duhet t'i qëllojë të tjerët me gurrë.

Ndërsa ndëshkimet që jepen në këtë mbretëri siç është prerja e dorës së vjedhësit, nuk ndodhin veçse sipas urdhërave të Allahut. Ai ka thënë: (ky është komentimi i ajetit) "**Vjedhësit dhe vjedhëses prejani duart, si shpagim i veprës që kanë bërë, (kjo masë është) dënim nga All-lahu. All-lahu është krenar, i mençur.**" (El-Maide: 38) Këto ligje i ka caktuar Zoti i botëve, më mëshiruesi i mëshiruesve. Në hadithin e Pejgamberit sal-lallahu alejhi ue sel-lem thuhet: "**Zbatimi i një ndëshkimi nga ato që ka caktuar Allahu është më mirë për ta sesa të bjerë shi dyzet mëngjese.**" Ndërsa ata që qajnë për kriminelët shkatërrues përsë nuk hidhërohen për të pafajshmit të cilëve u është derdhur gjaku ose u është marrë pasuria? Ndëshkimi i një fajtori mbron miliona njerëz nga loja e kriminelëve me ta. Gjykimi me ligjin e Allahut është irregullatori i gjithçkaje në tokë e nuk është shkelje e të drejtave të njeriut. Allahu i Madhëruar ka thënë: (ky është komentimi i ajetit) "(Ta zbritëm) Që ti të gjykosh me atë që të zbriti All-lahu, e mos ndiq dëshirat e tyre dhe ruaju rrezikut të tyre që mos të të shhangin nga një pjesë e asaj që ta zbriti All-lahu. Nëse ata refuzojnë (gjykimin tënd), dije se All-lahu ka për qëllim t'i ndëshkojë për disa mëkate të tyre. Me të vërtetë shumë prej njerëzve janë të prishur. A po kërkojnë gjykimin e kohës së injorancës. E kush mund të jetë gjykim më i mirë sesa ai i Allahut për popullin që bindshëm besojnë!" (El-Maide: 49-50)

O ju njerëz! Begatitë e Allahut ndaj nesh janë të shumta dhe madhështore e kërkojnë falenderimin e Allahut. Falenderimi i Allahut bëhet me devotshmëri dhe pasim të fesë së Tij. Allahu i Madhëruar ka thënë: (ky është komentimi i ajetit) "**Dhe (pëkujtoni) kur Zoti juaj njoftoi bindshëm: Nëse falënderoni, do t'uua shtoj (të mirat) ...**" (Ibrahim: 7)

Falenderimi i Allahut për këto begati bëhet duke qenë sot më mirë se dje dhe nesër më mirë se sot sepse Allahu na urdhëroi për devotshmëri në suren e parë të Kur'anit, urdhëroi për devotshmëri në ajetin e fundit që zbriti dhe në shumë ajete mes tyre urdhëroi për devotshmëri që muslimani të jetë i devotshëm në çdo rast dhe gjithmonë devotshmëria e tij të jetë në ngritje e kështu të fitojë mirësinë e kësaj bote dhe të botës tjetër. Allahu i Madhëruar ka thënë: (ky është komentimi i ajetit) "... e përfundimi i këndshëm i takon të devotshmëve." (El-Kasar: 83)

Feja jonë na detyron që të jemi si një dorë e vetme dhe një rresht i bashkuar me prijesat tanë përballë kërcënimive që synojnë Islamin, mësimet e tij dhe shoqërinë tonë. Jo vetëm kaq por ky vend ka të drejtat e tij ndaj çdo muslimani kudo në botë. Allahu i madhëruar ka thënë: (ky është komentimi i ajetit) "**Ndihmohuni për të mira dhe në të mbara, e mos u ndihmoni në mëkate e armiqësi dhe frikësojuni Allahut. Me të vërtetë All-lahu është ndëshkues i fortë.**" (El-Maide: 2) dhe "E mos u bëni si ata që u ndanë dhe u përqanë pasi u patën zbritur argumentet. Për ta do të ketë një ndëshkim madhështor."

(Ali Imran: 105)
Tregohuni të devotshëm ndaj Zotit tuaj dhe frikësojuni "... ditës kur do të ktheheni te All-lahu, dhe secilit i plotësohet ajo që ka fituar, dhe atyre nuk u bëhet padrejtësi." (El-Bekare: 281)

O robërit e Allahut! Robi sado adhurime të bëjë e të largohet nga haramet, nuk mundet që të falenderojë begatitë e Allahut ndaj tij. Por i mjafton atij që të njohi

begatitë e Allahut ndaj tij, të ndiejë se nuk ka falenderuar si duhet dhe të përpinqet sipas mundësisë të adhurojë Zotin e tij me sinqeritet duke pasuar Sunnetin. Falenderimi mund të bëhet edhe duke folur për begatitë. Allahu i Madhëruar ka thënë: (ky është komentimi i ajetit) "**E për të mirat që të dha Zoti yt, trego** (udhëzo njerëz)!" (Ed-Duha: 11) Falenderimi bëhet edhe duke e dashur atë që të ka begatuar. Bëhet me punë dhe vepra pra duke shtuar adhurimet dhe duke i shpenzuar begatitë për kënaqësinë e Allahut. Allahu i Madhëruar ka thënë: (ky është komentimi i ajetit) "**Veproni duke falenderuar, o familje e Daudit, e pak nga robërit e Mi janë falenderues.**" (Sebe: 13) Muhammedi sal-lallahu alejhi ue sellëm kur Aishja (Allahu qoftë i kënaqur prej saj!) i tha: O i Dërguar i Allahut, falesh natën aq sa të enjten këmbët edhe pse Allahu të ka falur gjynahet që ke bërë e që do të bësh. Ai u përgjigj: "*O Aishe, a mos të jem rob falenderues?*"

O robërit e Allahut! Kërkojini llogari veteve tuaja para se të bëheni banorë të varrezave dhe bindjuni Allahut aq sa të mundeni të shpëtoni prej një ndëshkimi të dhembshëm. "**Çështja e Kijametit është** (në shpejtësi) **vetëm sa të hedhësh një shikim, ose edhe më afër.**" (En-Nahl: 77)

www.alharamainonline.org